

Edona Hajrullahu, është zgjedhur Zëvendëse e Avokatit të Popullit, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 26.01.2018.

Edona Hajrullahu ka kryer studimet themelore ne Institutin e Rochesterit per Teknologji (RIT) në Kosovë, ku koncentim kryesor ka pasur fushën e Menaxhmentit dhe Ekonomise, ndërkaq si koncentrim dytësor, Shkencat Juridike. Studimet pasuniversitare i ka ndjekur ne fushen e Studimeve Evropiane ne Itali. Aktualisht vazhdon të ndjekë studimet për MBA në Universitetin e Shefilidit në Greqi.

Nga viti 2017-2018 ka qenë e punësuar si Eksperte e Edukimit për gjithëpërfshiren e femijëve të riatdhesuar dhe minoriteteve etnike në procesin arsimor, në GIZ-in Gjerman, në kuadër të projektit për Ngritjen e Kapaciteteve në Arsimin Fillor në Kosovë.

Gjatë viteve 2011-2016, me emërim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka ushtruar funksionin e Kryeshefes Ekzekutive të Agjencinë për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Gjatë kësaj periudhe, ka inicuar në Qeveri dhe ka udhëhequr grupe të ndryshme për hartim të akteve ligjore dhe strategjive nacionale, si Procedurat Standarde të Veprimit për Rastet e Dhunës në Famije; Masen Afrimative /Udhëzimin Administrativ për Regjistrimin e Pronës së Përbashkët në emër të dy bashkëshortëve; Planin e Veprimit Nacional për Zbatim të Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”, e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ku njëherësh është caktuar si udhëheqëse e Sekretariatit Ndërinstitucional për Monitorim dhe Zbatim të PVN për R1325, etj. Njëherësh, ka prezantuar në shumë konferenca kombëtare e ndërkombëtare, ku ka ligjeruar për tema të ndryshme, me fokus në çështjet gjinore.

Gjatë vitit akademik 2011/12, ka qenë e angazhuar si Asistent Profesoreshe në Kolegjin “European School of Law and Governance” ku ka asistuar në lëndën “Institucionet e Bashkimit Evropian”.

Gjatë viteve 2007-2010 ka punuar si asistente e redaktorit të lajmeve në RTV 21, si dhe si gazetare dhe autore e emisioneve socio-kulturore në Kohavision, duke u fokusuar në vecanti në fenomenet e ndjeshme shoqërore.

Gjatë periudhës së studimeve ka qene gjithashtu e angazuar me gjysëm orari në kuadër të administrates së universitetit, specifikisht në Departamentin e Rekrutimit dhe atij të Marredhenieve me Jashtë.

Përveç gjuhës shqipe, flet gjuhen angleze, gjermane, dhe italiane.

Edona Hajrullahu u lind në vitin 1988, në Tiranë.

Aktualisht jeton në Prishtinë. Është e martuar dhe ka dy fëmijë.